

Energy Sector Towards the Renewable Potential in the Albanian Context | Sektori i energjisë dhe BRE në kontekstin shqiptar

Rodion Gjoka^a

Summary

The energy sector in Albania today is a driving force toward major changes. Shifting from fossil fuels and atomic based energy sources with enormous impacts on the environment to harvesting energy from renewable resources is shaping countries and economies worldwide. But the energy sector remains historically vulnerable, dependent on yearly precipitation and the hydrographic regime of rivers. During the last decade, Albania has been a net importer of energy, especially during the summer time, indicating that hydro-dependence is not sustainable. The energy supply sector has the potential to collapse when combined with massive losses in transmission and irresponsible consumption behaviour. Furthermore, climate change effects have directly impacted the sector. For instance, in 2017, drought and reduced precipitation contributed to lower HPP basin levels, forcing OSHEE and KESH to import around 120 million EUR worth of electric energy. To date there are around 500 hydropower plants in Albania that are either operative, under construction, or planned. Of these, 105 are located in protected areas. Such power plants have had a significant impact on local biodiversity. Besides problems with production and supply, Albania has significant consumption problems as well. Public institutions and public lighting are major consumers, but are often unable to pay their bills. The Albanian housing sector is responsible for consuming at least 47% of the total amount of electric energy produced on a yearly basis.

This paper provides a description and analysis of Albania's energy situation with an emphasis on sustainability. It deals with production, consumption behaviour, efficiency, renewables, strategic orientation, and fostering an environmental and economic resilience of the sector. It concludes with policy recommendations regarding renewable energy potential in Albania.

Keywords: Renewable Energy, Sustainable Development, Climate Change, Hydropower, Innovation, Environment

Përmbledhje

Sektori i energjisë sot prezantohet si një forcë orientuese ndaj ndryshimeve rrënjësore që po ndodhin në Shqipëri. Kalimi prej burimeve energjetike me bazë fosile dhe atomike, me ndikim të theksuar në mjedis, drejt prodhimit të energjisë së rinovueshme po rijetëzon ekonomi dhe shtete në shkallë globale.

Contact | Kontakt

^arodion_gjoka@co-plan.org (Corresponding author)

Co-PLAN, Institute for Habitat Development, Permanent Workshop on Territorial Governance
POLIS University, Tiranë, Shqipëri, www.co-plan.org; www.universitetipolis.edu.al

Ndërkohë, në kontekstin tonë, ky sektor ka mbetur historikisht si një variabël e prurjeve atmosferike dhe regjimit hidrografik të lumenjve e burimeve. Gjatë dekadës së fundit, çdo vit, Shqipëria është paraqitur si një importues neto i energjisë elektrike, kryesisht gjatë periudhës së verës, duke dëshmuar qartësisht për varësinë e sistemit nga një regjim i paqëndrueshëm hidrologjik. Kjo situatë bart një rrezik potencial dështimi në rast se kombinohet me humbje të mëdha dhe sjellje të papërgjegjshme ndaj konsumit të energjisë. Për më tepër, efektet nga ndryshimet klimatike (NK) kanë prekur drejtpërdrejt këtë sektor. Për shembull, thatësira dhe reshjet e reduktuara gjatë vitit 2017 kontribuan në uljen e baseneve ujëmbledhëse të hidrocentraleve, duke detyruar në këtë mënyrë OSSHEE dhe KESH të importojnë rreth 120 milionë euro energji elektrike. Aktualisht në Shqipëri regjistrohen rreth 500 hidrocentrale, operative/në ndërtim ose të planifikuara prej vitit 2005. Nga këto, 105 janë të pozicionuar në zona të mbrojtura. Këto vepra inxhinierike kanë pasur një impakt të qenësishëm në mjedisin dhe biodiversitetin lokal. Përpos problematikave në prodhim dhe transmetim, Shqipëria ka një problem edhe më të madh i cili lidhet me konsumin, kryesisht nga ana e infrastrukturave publike, të cilat jo vetëm rezultojnë si konsumatorët më të papërgjegjshëm, por kanë edhe aftësi të ulët për të mbuluar faturën e energjisë. Nga ana tjetër, sektori banimit është përgjegjës për konsumin e të paktën 47% të sasisë totale të energjisë së prodhuar në një vit.

Ky artikull prezanton përfundimet e një procesi kërkimor mbi situatën energjetike shqiptare në këndvështrimin e qëndrueshmërisë. Do të trajtohen prodhimi, konsumi, efienca, burimet e rinovueshme të energjisë (BRE), orientimi strategjik dhe nxitja e qëndrueshmërisë mjedisore dhe ekonomike të këtij sektori.

Fjalë kyçe: Energji të rinovueshme, zhvillim i qëndrueshëm, ndryshimet klimatike, hidrocentrale, inovacion, mjedis

Introduction

Forecasts declare that by 2050, 70% of the world's population will be concentrated in major cities, covering less than 2% of earth's surface. Pollution, access to infrastructure, traffic congestion and mobility, and safety and public health challenges will be the defining factors of future urban development and lifestyle (United Nations, 2014). One of the main problems for cities in the near future is meeting the increasing demand for energy. As the energy sector is mainly based on fossil fuels and other unsustainable sources, the volatility of market prices has become a permanent issue. It is expected that the energy sector will further increase pressure on the environment, resulting in the continued depletion of resources and environmental degradation. "Energy production and consumption is the single largest source of greenhouse gas (GHG) emissions, representing almost 70% of global emissions. States and markets have been slow to change, and

Hyrje

Parashikimet deklarojnë se, deri në vitin 2050, rreth 70% e popullsisë botërore do të përqendrohet në qytetet e mëdha, të cilat nuk përbëjnë më tepër se 2% të sipërfaqes së tokës. Ndotja, aksesin në infrastrukturë, trafiku i ngarkuar, transporti, siguria dhe shëndeti publik do të jenë sfidat kryesore të cilat do t'u japin formë zhvillimeve urbane dhe mënyrës së jetesës në të ardhmen (United Nations, 2014). Një nga problematikat kryesore për qytetet në të ardhmen e afërt do të konsistojë në sigurimin dhe mbulimin e nevojave në rritje për energji. Duke qenë se sektori energjetik është kryesisht i furnizuar nga burime të paripërtërishme dhe fosile, ndryshueshmëria e çmimit është tashmë një problem permanent. Ndërkohë pritet që ky sektor të shtojë edhe më tepër presionin mbi mjedisin duke varfëruar burimet natyrore dhe duke degraduar mjedisin në tërësi. "Prodhimi dhe konsumi i energjisë është burimi emetues më i madh i gazeve të efektit serë (GES), përgjegjës

world carbon emissions continue to rise" (Van de Graaf & Colgan, 2016, p. 2).

Major cities in Albania such as Tiranë, Durrës and Vlorë are feeling enormous pressure from air pollution and extreme heat, experiencing psychological effects on the population and permanent disturbance from noise pollution, and suffering from the effects of infections deriving from polluted drinking and surface waters (Instituti i Shëndetit Publik, 2014). While daily energy consumption sets records year after year, due to several physical and planning factors as well as increased incomes among the population, an important sectorial reorientation is needed that takes into consideration financial and environmental impacts on an individual and community level. Since the development transition initiated in the early 1990s, the Albanian energy sector has faced numerous challenges, including an ageing electricity generation and transmission system and a management struggle from state ownership to the private sector and back again. These challenges are cross-sectorial – as will be illustrated below, with energy efficiency (EE) and consumption behaviour as some of the most significant obstacles to overcome (REC, 2015).

Energy as a driving force for both economic and social development in Albania received particular attention after the energy crisis of the late 1990s, when the system could not support public supply without interruptions (UNDP & AIIS, 2004).

Albania's geographic position along the Mediterranean basin (coastline of 476km) gives it a climate characterized by wet and mild winters and warm and dry summers. Proximity to the sea and a diverse topography are the main factors influencing the climate (IGJEU, 2017). Key meteorological figures for Albania¹ indicate an average annual temperature of 8-9°C in mountainous areas and 17°C in coastal areas (IGJEU, 2017). The daily average solar radiation varies from 3.2 kWh/m² in the northeast, to up to 4.6 kWh/m² in the south-western part of the country. Albania registers 2,400 hours of sunshine per year with an average of 240-300 solar days (AKBN & PNUD, 2016). These figures indicate a significant potential to integrate solar systems (photovoltaic) for domestic and industrial production of electric energy (Co-PLAN, 2007).

për të paktën 70% të emetimeve të këtij gazi në rang global. Shtetet dhe tregjet kanë qenë të ngadaltë ndaj ndryshimit apo qasjeve të reja dhe rrjedhimisht emetimet e karbonit vijnë të rriten" (Van de Graaf & Colgan, 2016, p. 2).

Problematikat e sipërpërmendura, ndonëse në një shkallë më të vogël, janë aktualisht të pranishme dhe kanë impakt në shoqërinë shqiptare. Qytete kryesore si Tirana, Durrësi dhe Vlora tanimë ndjejnë presionin dhe shqetësimet nga ndotja e ajrit urban dhe nga valët e të nxehtit ekstrem dhe thatësirës së tejzgjatur, efektet psikologjike dhe shqetësimin konstant nga zhurmat në mjedis si dhe preken nga infeksione të cilat vijnë si pasojë e përdorimit të ujit të pijshëm dhe ujërave sipërfaqësore (Instituti i Shëndetit Publik, 2014).

Në një kohë kur konsumi i energjisë elektrike thyen vit pas viti rekordet si pasojë e faktorëve fizikë dhe planifikues si edhe e rritjes së të ardhurave, lind nevoja që të kryhet një riorientim i sektorit duke marrë në konsideratë implikimet financiare dhe mjedisore në nivel individit dhe komunitetesh. Sektori energjetik në Shqipëri, që prej fillimit të tranzicionit dhe zhvillimeve të viteve '90, është përballur me një larmi problematikash, ndër të cilat më kryesoret kanë qenë trashëgimi i një sistemi në vjetrim të vazhdueshëm, kalimi nga operatori shtetëror tek ai privat dhe rishtetëzimi i kohëve të fundit. Sfidat që na paraqiten janë ndërsektoriale, siç edhe do të vërehet më poshtë, dhe përmirësimi i eficiencës energjetike dhe ndryshimi i sjelljes së konsumatorit janë ato më të vështirat për t'u kapërcyer (REC, 2015).

Energjia si një motor shtytës për ekonominë dhe zhvillimin social në Shqipëri ka marrë një vëmendje të veçantë, sidomos pas krizës energjetike të fundviteve '90 kur sistemi nuk ishte në gjendje të përballonte kërkesën e tregut për furnizim me energji pa intervale të gjata ndërprerjesh gjatë ditës dhe vitit (UNDP & AIIS, 2004). Pozicioni gjeografik i Shqipërisë përgjatë bregdetit Mesdhetar (476 km shtrirje bregdetare) karakterizohet nga një klimë me dimër të lagësht e të butë dhe verë të thatë e të nxehtë. Afërsia me detin por, edhe përbërja topografike e larmishme janë faktorët kryesorë që ndikojnë në klimën e vendit tonë (IGJEU, 2017). Të dhënat kryesore meteorologjike për Shqipërinë¹ paraqesin një mesatare vjetore të temperaturës nga 8-9°C për

Production


In 2006, the government made a 'premature' intervention by approving Law no. 9663, date 18.12.2006, 'On Concessions' that granted water resource management rights for energy production purposes to the private sector (AKBN, 2006). The government also launched a campaign that raised awareness about the fact that at least two-thirds of Albania's hydro potential is unexploited. As a result, several applications for concessions by private companies followed. To date, there are at least 496 hydropower plants (HPPs) in Albania that are either operative, under construction, or have been planned since 2005. Of these, 105 are located in protected areas. At least 110 plants have been constructed and became operational since 2005. The peak year for hydropower plans was 2016, when 25 plants became operational (River Watch Balkan, 2018). There are another 285 projected and planned plants waiting for permissions and contractual engagements between parties, 55 of which are planned to be in protected areas (ibid.). Negative environmental impacts such as reduction of protected areas, fragmentation of natural landscapes, and losses of biodiversity have been identified (Hoxha, 2018). For instance, in cases of HPPs using a system of water basins and dams, the water in the reservoir is usually stagnant and flows slower compared to natural river streams. As a result, by having lower oxygenation levels, the amount of sediments and nutrients that are needed to cultivate an excess of algae and other aquatic weeds is considerably higher. This has a direct impact on the existing aquatic ecosystem, which cannot adapt to such sudden changes. This occurs more aggressively at the reservoir base where the temperature is lower and dissolved oxygen reaches its minimum compared to a normal river flow. As for the HPPs that deviate watercourses and streams by channelling most of the surface flow into a pipe (often from source to turbine), there are varying degrees of impact on terrestrial and aquatic species and on riparian belts (Arthington, 2002). Besides affecting biodiversity, water management for energy production purposes leads to droughts, reduced water quantities, and, in the case of Albania, limited access for local residents and rural economies to water resources, and a reduced

zonat malore dhe 17°C për zonat fushore dhe bregdetare (ibid). Rrezatimi ditor mesatar varion nga 3.2 kWh/m² në zonat verilindore të vendit deri në 4.6 kWh/m² në jugperëndim. Shqipëria regjistron rreth 2400 orë me diell në vit dhe në total nga 240 - 300 ditë me diell (AKBN & PNUD, 2016). Këto të dhëna pasqyrojnë një potencial të qenësishëm për sa i përket integritetit të sistemeve diellore (fotovoltaike) për prodhim individual por edhe në shkallë të gjerë (Co-PLAN, 2007).

Prodhimi

Në 2006, qeveria ndërmori një iniciativë të 'pamaturuar' duke aprovuar ligjin mbi koncesionet – Ligji nr. 9663, datë, 18.12.2006, 'Për Koncesionet' (AKBN, 2006), përmes të cilit i delegohej privatit e drejta për menaxhimin e burimeve ujore me qëllim prodhimin e energjisë. Një fushatë e gjerë tërhoqi vëmendjen e publikut dhe biznesit duke nënvizuar faktin se të paktën 2/3 e potencialit hidrik ishte e pashfrytëzuar. Si rezultat, fushata pasardhëse konsistoi në një seri intensive aplikimesh për koncesione nga kompanitë private. Deri më sot, numërohen të paktën 496+ hidrocentrale, operative/në ndërtim ose të planifikuara apo të miratuara që prej 2006. Prej këtyre, 105 janë të pozicionuara në brendësi të zonave të mbrojtura. Të paktën 110 hidrocentrale janë operative prej vitit 2005: 46 prej tyre filluan prodhimin gjatë viteve 2015-2017 dhe piku u arrit në vitin 2016 gjatë të cilit 25 hidrocentrale përfunduan dhe nisën menjëherë prodhimin (River Watch Balkan, 2018). Situata bëhet më komplekse në momentin kur prezantohen rreth 285 projekte dhe plane për hidrocentrale të cilat janë në procesin e aplikimit për leje nga institucionet qendrore dhe 55 prej të cilave janë në brendësi të zonave të mbrojtura (ibid). Janë identifikuar dhe regjistruar impakte të ndryshme negative të këtij fenomeni në mjedis (Hoxha, 2018), ndër të cilat ato më kryesoret kanë të bëjnë me zvogëlimin e shtrirjes së zonës së mbrojtur, tjetërsimin dhe copëzimin e peizazhit natyror, humbjen e biodiversitetit, etj. Për shembull, në HEC-et që përdorin teknikën e kontrollit të rrjetit hidrografik nëpërmjet baseneve me digë, uji, tanimë pjesë e rezervuarëve, në të shumtën e rasteve paraqitet më i ndenjur dhe regjimi i rrjedhjeve gravitacionale është më i ulët se ai i lumenjve natyralë. Si rezultat, duke

Figure 1 | Figura 1. Highlighted HPP projects within National Parks and Protected Areas in Albania | Pozicionimet e projekteve të HEC² në brendësi të zonave të mbrojtura dhe parqeve kombëtare në Shqipëri



Source | Burimi: Co-PLAN on behalf of ENV.NET² Project based on RiverWatch data, 2018 | Co-PLAN në kuadër të projektit ENV.NET³/referuar të dhënave nga RiverWatch, 2018

amount of sediment reaching the seashore, which itself suffers from rising sea levels.

During 2017, climate and meteorological conditions in the Balkans were marked by extreme heat and prolonged droughts during summer and fall, combined with heavy and concentrated precipitation during a two-week period in the wintertime, which had a direct effect on the region's hydro-regime, including in Albania. In this context, the small scale HPPs were faced with new climate conditions for the region, which reduced water quantities and constrained them to produce even less than the minimum projected and declared by their installed capacity (ERE, 2016).

During 2016, the net generation of electric energy provided 100% by HPPs was 7,136,353 MWh - 5,091,616 MWh from public HPPs and 2,044,737 MWh from privately owned HPPs (ERE,

pasur nivele më të ulëta të oksigjenit të tretur dhe ndryshim të teksturës sipërfaqësore ku rryma lumore çliron energjinë kinetike, sasia e sedimenteve dhe ushqyesve të cilët nevojiten për të kultivuar një spektër të caktuar algash dhe vegjetacioni është tepër e lartë. Këta faktorë kanë impakt të drejtpërdrejtë mbi ekosistemin ujor, i cili, në mungesë të faktorit kohë, nuk mund të zhvillojë mutacionet e nevojshme për t'u përshtatur me këto ndryshime. Pra, impaktet agresive janë regjistruar në ato rezervuare ku temperaturat janë më të ulëta si pasojë e thellësisë artificiale dhe oksigjeni i tretur ka vlera minimale krahasuar me ujërat të cilat ndjekin rrjedhën natyrale. Ndërkohë, HEC-et të cilat përdorin teknikën e devijimit të rrjedhës lumore dhe përrrenjve nëpërmjet kanalizimit thuajse të të gjithë prurjes natyrale në tubacione, në shumicën e rasteve nga burimi ujor deri në turbinën elektrike, kanë një amplitudë të

2016). Albania's average demand for energy is set between 6.5-7.5 GWh/year and is not covered by the existing installed capacity due to a lack of compliance between the consumption sector and production policies, as well as network losses³. Overall, since 2003, there have been at least 2 GWh/year net losses, resulting in a dependency on imports. About 3 GWh per year are imported from regional producers (ERE, 2016). Energy sector development during the last decade oriented investments towards HPPs and created a national market that is strongly connected with weather conditions and climate change (CC) effects. It can be seen as a clean, but unsustainable system. Instead of constricting end-users with unfair energy policies and respecting concession contracts with small HPPs, a new energy market should offer everybody the opportunity to produce energy and share it with others in the system, reducing the costs of energy consumption, transmission losses, and energy production.

The above context indicates that focusing on hydropower systems of energy production is not a sustainable solution for many reasons:

- The existing systems are compromised, inefficient, and experience a loss of energy;
- The use of water as a source of energy is clean, but the effects of the related infrastructure on the river and adjacent ecosystems is negative, with costs exceeding benefits especially in a climate high-risk context; and
- Private HPPs have little to no concern for the ecosystem in which they operate. Furthermore, the number of private plants is high and they are located or are planned to be located in every river and stream in Albania. Energy production as a profitable business is the driving force behind private HPPs. Though the government has adopted an updated national energy plan, the latter does not embrace an integrated approach that: covers all types of sources; considers cross-sectorial, territorial, and environmental effects; and takes into account the cross-border impacts.

In these circumstances, two challenges remain to be faced by the government and society in terms of the energy sector: 1) the decreasing quantity of energy supplied by the current system

gjere impaktesh në speciet tokësore dhe ujore si dhe në brezin riparian (Arthington, 2002). Përpos ndikimeve në biodiversitet, menaxhimi i ujërave për qëllime të gjenerimit të energjisë në shumë raste sjell si pasojë thatësira, kufizim të aksesit natyror në ujërat e ëmbla për banorët e zonës dhe ekonomitë rurale e, për më tepër, sasia e sedimenteve që duhet të shpërndahej përgjatë basenit, më pas në deltë dhe së fundmi në bregdet ulet ndjeshëm, në një moment në të cilin rritja e nivelit të detit për shkak të NK ka çuar në rritjen e sjelljes agresive ndaj vijës bregdetare.

Gjatë vitit 2017, situata klimatike dhe meteorologjike në rajonin e Ballkanit u karakterizua nga valë të gjata të nxehti si dhe nga një thatësi e tejzgatur për periudhën e verës e vjeshtës, kombinuar kjo me reshje të dendura, të përqendruara në kohë përgjatë një periudhe 2-javore gjatë dimrit. E gjithë kjo pati një efekt të drejtpërdrejtë në regjimin hidrik të rajonit, përfshirë edhe Shqipërinë. Në këtë kontekst, HEC-et me kapacitet të instaluar të vogël u përballën me vështirësitë e këtij regjimi të ri klimatik, i cili i detyroi ato të prodhojnë më pak energji sesa minimumi i kapacitetit të tyre të deklaruar (ERE, 2016).

Ndërkohë, të dhënat përmbledhëse të sektorit për vitin 2016 vërtetojnë se energjia elektrike u gjenerua 100% nga burimet hidrike, pra nga HEC-et, për një total prej 7,136,353MWh, prej të cilave 5,091,616MWh nga HEC-et shtetërore dhe 2,044,737MWh nga HEC-et private (ERE, 2016). Kërkesa mesatare vjetore për energji në Shqipëri varion ndërmjet 6.5-7.5GWh/vit. Kjo kërkesë nuk arrin të plotësohet nga kapaciteti ekzistues i instaluar si pasojë e mungesës së përputhshmërisë midis sektorit konsumator dhe politikave të gjenerimit dhe sigurisht edhe si pasojë e humbjeve në sistemin e transmetimit⁴. Përgjithësisht, prej vitit 2003, janë regjistruar të paktën 2GWh humbje në vit, gjë që shpjegon varësinë e sistemit tonë energjetik nga importi. Mesatarisht, Shqipëria importon çdo vit rreth 3GWh energji elektrike nga prodhues rajonalë (ERE, 2016).

Zhvillimet kryesore të sektorit energjetik në vend, të paktën në dekadat e fundit, kanë orientuar investimet drejt HEC-eve dhe kanë krijuar një treg të brendshëm i cili shfaqet ngushtësisht i lidhur me kushtet atmosferike dhe efektet e NK.

(water based); 2) the gap between demand and supply due to not using alternative energy sources to date. The following sections deal with this second challenge in particular. They focus on the related policy framework and provide policy recommendations on how to tackle near-future energy shortages through investing on a diversified energy system.

Consumption

The housing sector is responsible for at least 47% of total electric energy consumption in Albania (IFC & AKBN, 2010). The housing sector contributes 96,000 tons/year of CO₂ emissions into the atmosphere, leading to increasing global warming.


These figures also take into consideration the average losses due to the low efficiency of electrical appliances, as well as the low thermal insulation properties of Albanian housing. Preliminary indications⁴ show that at least 29% of the annual energy consumption of a typical 75-80 m² apartment is lost energy. This results in 28,800

Ky sektor mund të vlerësohet si një sektor i pastër (pa emetime), por thellësisht i paqëndrueshëm. Në vend që të ngarkohen konsumatorët fundorë me politika të papërshtatshme energjetike, kjo për të respektuar marrëdhënien kontraktuale (koncesionare) me HEC-et e vogla, do të ishte e nevojshme të prezantohej një treg i ri energjetik, i cili të krijojë mundësi teknike dhe politike për të prodhuar energjinë në mënyrë individuale dhe për ta ndarë atë me palë të treta nëpërmjet sistemit ekzistues, duke reduktuar kështu njëherazi koston e prodhimit të energjisë për njësi, konsumin final të energjisë, humbjet në transmetim dhe duke u ofruar HEC-ve mundësinë për një prodhim të planifikuar e të qëndrueshëm.

Tematika e sektorit, e trajtuar në kontekstin e mësipërm, tregon se përqendrimi në sistemet hidroenergjetike për prodhimin e energjisë elektrike nuk është një zgjidhje e qëndrueshme për shumë arsye:

- Sistemet ekzistuese paraqiten të komprometuara dhe inefficente si dhe

Figure 2 | Figura 2. Key energy consumption figures, recommendations to increase household energy performance | Të dhëna kryesore mbi energjinë e konsumuar dhe këshilla mbi si mund të rritet performanca energjetike në sektorin e banimit.



Source | Burimi: Co-PLAN (2018) (data obtained from Yearly National Energy Report – ERE) | Co-PLAN (2018) me të dhëna të marra nga Raporti Kombëtar Vjetor i ERE për Energjinë

tons of CO₂ emitted into the atmosphere because of the poor performance of old and outdated appliances and insulation (REC, 2015). Public infrastructure also shows irresponsible behaviour regarding energy consumption and emission of CO₂.

Such behaviour has persisted since 1991, because energy costs were either accumulated as an entity's public debt, or reflected in the tariff of the respective service. Even nowadays, whenever operational costs exceed income from current taxation, the respective energy tariff is often revised and raised accordingly.

Furthermore, there is lack of maintenance and inefficient investments in public lighting. For instance, old technology is often replaced manually without implementing any innovative practices and projects such as bio-regime LED lighting for urban areas (EkoLëvizja, 2014).

Tackling a major problem such as energy demand, use, and its impacts on the environment requires a major behavioural shift at all levels – from the individual as the end-consumer, to the national energy governance system. The main reasons for a renewed interest in energy in Albania are currently related to awareness of the effects of CC, the increasing volatility of oil and gas markets, and an unstable economic forecast for the country if it continues to rely on fossil fuels and hydropower. For instance, Albania imported 47% of its total consumed energy throughout 2017, indicating serious supply problems that require immediate solutions, including, as abovementioned, diversification of the sector with renewables as key. Regarding fuel, the government has imposed one of the most aggressive taxes, whereby 63% of the final price of fuel is comprised of taxes and the price per litre is one of the most expensive in the region, despite Albania being one of the largest producers in the region.

Another driving force mainstreaming the topic of energy in the country is the private interests and investments in HPPs and the interest to invest in Photovoltaics (PVs) and Eolic systems, mainly seen from a business profitability perspective.

Albania has good potential for producing energy from renewable sources, as meteorological stations register 2,400 hours of sunshine per year

përjetojnë humbje të larta energjetike.

- Përdorimi i ujërave si gjenerues të pastër të energjisë elektrike sjell impakte negative të infrastrukturës përkatëse, e cila i mbivendoset regjimit natyror të ujërave dhe ekosistemeve dhe kostoja e të cilës i tejkalon përfitimet, sidomos në një kontekst ku rreziku klimatik është i lartë.
- HEC-eve private u interesojnë pak, për të mos thënë aspak, ekosistemet në të cilat veprojnë. Për më tepër, numri i HEC-eve të vegjël është tejet i lartë dhe gjeografikisht ata janë të pozicionuar apo të planifikuar në thuajse çdo lumë e përrua të Shqipërisë. Gjenerimi i energjisë dhe tregtimi i saj është biznes fitimprurës, i cili shtyn investimet private në ndërtimin e HEC-eve. Megjithatë, qeveria ka të adoptuar një plan kombëtar për të gjithë spektrin energjetik të vendit si edhe dedikuar BRE në veçanti. Problemi është që sa më vonë ajo të integrojë dhe të nisë të trajtojë çështjet e diversifikimit të sektorit, mbulimit të të gjitha burimeve të disponueshme, marrëdhënieve ndërsektoriale dhe territoriale, efekteve mjedisore dhe marrëdhënieve e implikimeve ndërkufitare, aq më tepër do të cenohet ky sistem energjetik i paqëndrueshëm.

Në këto rrethana, dy janë sfidat kryesore të cilat mbeten për t'u ballafaquar nga përfaqësia politike dhe teknike e qeverisë qendrore si edhe nga shoqëria civile: 1) sasia në rënie e energjisë së siguar nga sistemi ekzistues (hidrocentralet); dhe 2) mospërputhja ndërmjet konsumit dhe furnizimit si pasojë e mosaktivizimit të gjenerimit të energjisë nga burime alternative deri më sot. Pjesët e mëposhtme të këtij artikulli trajtojnë më në detaj këtë sfidë. Ato fokusohen tek korniza ligjore dhe politike si dhe rekomandojnë politika mbi mënyrën se si mund të adresohet në terma afatshkurtër problematika e mungesës së energjisë elektrike nëpërmjet investimeve në diversifikimin e sektorit elektroenergjetik.

Konsumi

Sektori i banimit është përgjegjës për të paktën 47% të konsumit total të energjisë elektrike në Shqipëri (IFC & AKBN, 2010). Po ky sektor vlerësohet të kontribuojë me rreth 96,000 ton/vit

with an average of 240-300 solar days (AKBN & UNDP, 2016). These figures indicate a significant potential for the integration of solar systems (PVs) for domestic and industrial production of electric energy (Co-PLAN, 2007). However, such potential, including wind and geothermal energy, is minimally exploited currently in Albania.

Potential of Renewable Energy Sources and Energy Efficiency in Albania

As Albania is undertaking legal and institutional reforms on behalf of the European Integration process, the Ministry of Infrastructure and Energy (MIE) established the Energy Efficiency Agency (EEA) and the Directorate of Renewable Energies in 2016 to ensure the transposition and implementation of legislation. These new entities should make sure that the government's commitments regarding energy source diversification, EE, renewable energy and market liberalization are achieved (Energy Community Secretariat, 2017).

For instance, Law no. 124/2015 'On Energy Efficiency' assigns the EEA with responsibilities to ensure that objectives deriving from the National Energy Action Plan (NEAP) are met and implemented accordingly. This law also defines means for implementation, such as review of the construction code to enable an energy audit and classification system by 2018, as an official process that identifies and classifies the existing consumer stock in Albania. These processes are crucial for meeting the 6.8% overall energy savings goal for all sectors, though in reality central government and the MIE are not supporting the agency to implement them.

The Europeanization process and progress in the energy sector for Albania can only be tracked with regard to legal adaptation to the EU *acquis*, while implementation and actual public investments do not reflect an increase in consumption efficiency, or in the diversification of production sources. However, advancements have been made in terms of the legislation approximation process. The government has transposed the Energy Community Treaty and Climate Mitigation obligation from the Paris Agreement into Law no. 7/2017 'Incentive for Energy Production and Usage

emetime të CO₂ në atmosferë, duke qenë kështu një kontribues, sado i vogël, në ngrohjen globale.

Këto të dhëna, duke marrë në konsideratë gjithashtu edhe humbjet mesatare vjetore si pasojë e konsumit joeficient të pajisjeve elektroshtëpiake si edhe termoizolimim në banesat shqiptare, tregojnë paraprakisht se të paktën 29% e totalit të energjisë së konsumuar nga një apartament tipik prej 75-85m² humbet⁵. Kështu, sasia prej 28,800 ton e CO₂ e emetuar në atmosferë mban firmën e performancës së ulët termike të banesave dhe performancës së ulët energjetike të elektroshtëpiakeve (REC, 2015). Përpos të tjerave, infrastruktura dhe shërbimet publike japin një model të papërgjegjshëm për sa i përket konsumit energjetik dhe emetimeve të CO₂ dhe të ndotësve të tjerë në atmosferë. Kjo sjellje është trashëguar prej vitit 1991, kur kostot e sasisë së energjisë së konsumuar akumuloheshin në formën e borxhit publik ose reflekttoheshin tek tarifa e shërbimit që mbulohej nga individ. Madje, edhe në ditët e sotme, thuajse në të gjitha rastet në të cilat kostot operacionale tejkalojnë të ardhurat nga skema ekzistuese e taksimit, tarifa përkatëse e energjisë elektrike rishikohet me tendencën për të reflektuar shtesat e nevojshme.

Për më tepër, ekziston një mungesë angazhimi në mirëmbajtje si dhe investime strategjike joeficiente në sektorin e ndriçimit publik (EkoLevizja, 2014). Për shembull, teknologjitë e vjetra zakonisht zëvendësohen manualisht, pa marrë në konsideratë integrimin e praktikave inovative dhe prezantimin e projekteve ku ndriçimi urban realizohet nëpërmjet teknologjisë LED me regjim biologjik.

Ballafaqimi me problematikat kryesore si kërkesa për energji, përdorimi dhe impaktet mjedisore të sektorit kërkon një riorientim të sjelljes në të gjitha nivelet, prej individëve si konsumatorë fundorë tek sistemi qendror planifikues dhe menaxhues i sektorit energjetik. Arsyt kryesore të cilat risollën vëmendjen në sektorin energjetik në Shqipëri aktualisht janë të lidhura me ndjeshmërinë ndaj efekteve si pasojë e NK, paqëndrueshmërinë e çmimit në tregjet e naftës dhe gazit, si dhe skenarët ekonomikisht të paqartë që lidhen me vijimin, ose jo, të varësisë së vendit nga burimet fosile dhe hidrologjike për sigurimin e energjisë bazë. Si shembull konkret, Shqipëria importoi 47%

from Renewable Sources'. Moreover, the 'National Action Plan on Renewable Energy Sources 2018-2020' was revised, taking into consideration obligations deriving from commitments undertaken since the Paris Agreement. Nevertheless, related implementation measures are missing or are slow to be realized. Most market liberalization efforts so far have been oriented at facilitating private operators' ability to directly trade their energy to end-users in the domain of water-based energy. Hence, until recently the government had followed a uni-directional approach in liberalizing the market.

Introducing alternative forms of energy production and energy exchange in the network between individual producers and OSHEE will most probably affect the current HPP system, energy prices at large, and competition. A lack of prior studies to assess the shift from a purely hydropower energy system to a diversified system impedes the government and interested stakeholders from taking rational and timely decisions, therefore leading to a stalled situation with regards to the implementation of the above laws.

In this context, the implementation of Law no. 7/2017 'On Incentive for Energy Production and Usage from Renewable Sources', which supports the integration of renewable energies in Albania, is faced with two challenges.

- First, during 2017 and 2018, a wide interest was expressed by the private sector to apply for licenses and permits to construct PV centrals with a maximal installed capacity of 2 MW and energy trade of 100 EUR per MW. There were at least 50 applications declared by the MIE as of May 2018, but so far no construction has started and bureaucracy has delayed the process by more than eight months. Regarding smaller installations (up to 500 kWp⁵) there are no legal restrictions though there is a major gap in terms of financial feasibility and regulated relationship between private producers and transmission operators. The absence of a net-metering system, subsidies, and a joint agreement with OSHEE and Transmission System Operator as the operators in charge of regulating energy consumption and production with small scale

të totalit të energjisë së konsumuar gjatë vitit 2017, çka përbën një indikator serioz për sa i përket problemit të sigurimit dhe mbulimit të nevojës së brendshme për energji, i cili kërkon një zgjidhje strategjike dhe sa më të shpejtë. Lidhur me këtë, siç është theksuar, diversifikimi i burimeve gjeneruese është një nga zgjidhjet më të përshtatshme. Për sa i përket lëndës djegëse (naftë, benzinë dhe nënprodukte), qeveritë kanë aplikuar një nga praktikatat më agresive të taksimit, ku 63% e çmimit final të këtij produkti përbëhet nga taksat duke e pozicionuar lëndën djegëse ndër më të shtrenjtat në rajon, pavarësisht faktit se Shqipëria është një nga prodhuesit më të mëdhenj, jo vetëm në rajon.

Një tjetër forcë kryesore me impakt në temën e energjisë në nivel vendi janë edhe interesat private dhe investimet fizike në HEC-e si dhe interesat për të investuar në sistemet fotovoltaike dhe eolike. Këtu kryesisht nënkuptojmë pikëpamjen e një biznesi me perspektivë fitimprurëse.

Shqipëria zotëron në vetvete një potencial të kënaqshëm në prodhimin energjetik nga burime të rinovueshme. Regjistrimet e 7 dekadave të fundit në stacionet tona meteorologjike paraqesin një mesatare vjetore prej 2,400 orësh efektive me diell dhe rreth 230-240 ditë me diell (AKBN & UNDP, 2016). Janë pikërisht këto të dhëna (*ku normalisht ndryshimet e regjimit klimatik kanë ndryshuar dhe intensitete rrezatimi që më parë regjistroheshin gjatë verës tani janë të shtrira deri në nëntor*) që tregojnë qartësisht potencialin për të integruar në spektrin e përdorimit energjetik individual/lokal dhe industrial mbi të gjitha sisteme diellore (fotovoltaike) (Co-PLAN, 2007). Ndërkohë, një potencial i tillë, përfshirë potencialin eolik dhe atë gjeotermal, në vendin tonë është i shfrytëzuar në nivel minimal.

Potenciali i BRE dhe EE në Shqipëri

Duke qenë se Shqipëria po ndërmerr reforma ligjore dhe administrative në funksion të procesit të përafrimit dhe integritimit evropian, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) themelon Agjencinë e Eficiencës së Energjisë (AEE) dhe më herët, në 2016, Drejtorinë e Politikave të Burimeve Alternative. Këto janë dy entitetet kyç nëpërmjet të cilave qeveria e Shqipërisë siguron se të gjitha angazhimet e marra për diversifikimin e burimeve

producers and individuals are the main factors why PV has not yet become mainstream in Albania, even though the potential is there. Still, this has not stopped private initiatives to make use of PV systems, primarily among businesses that have a high rate of energy consumption during the summer season (such as hotels and resorts).

- Second, at the local level, energy consumption remains high as public services such as street and road lighting, water supply pumps, and public dwelling stock have not undergone any intervention to integrate energy efficiency measures.

On the other hand, the EE law does not appear to be fully aligned with the *acquis*, since there is no fund allocated for the implementation of the measures deriving from this law (for instance, the establishment of administrative capacities) other than support schemes from donors. Even donor support is not well addressed and often the grid is not enabled and managed, as in the case of KfW (Kreditanstalt für Wiederaufbau) financial support (SCAN, 2018), where the Government of Albania (GoA) would have supported small and medium enterprises (SMEs) by providing a credit of 12 million EUR without interest. In addition, the secondary legislation regarding energy performance in buildings is lagging behind in terms of implementation (European Commission, 2018). A number of obligations and commitments deriving from Law no. 124/2015 'On Energy Efficiency' are not met and were substantially neglected, mainly because of insufficient institutional capacities, but also due to the lack of support from third parties, donors, and the government (Laci, et al., 2016). EE measures constitute an energy source per se and have the unique potential to simultaneously contribute to long-term energy security, economic growth, and even improve health and human wellbeing. In particular, EE can reduce GHG emissions. By reducing or limiting energy demand, EE measures can increase resilience against a variety of risks, such as energy price rises and volatility, stress on energy infrastructure, and the distribution of energy supply systems (ECM, 2016).

Such EE measures, combined with enabled alternative energy sources, would support the government in achieving its commitment to

energjetike, integrimin e eficiencës energjetike dhe liberalizimin e tregut energjetik janë zbatuar dhe kapacitetet janë instaluar sipas detyrimeve (Energy Community Secretariat, 2017).

Rasti konkret, Ligji nr. 124/2015 'Eficienca e Energjisë', ngarkon AEE-në me përgjegjësinë për të përmbushur objektivat që rrjedhin nga Plani Kombëtar i Veprimit për Eficiencën e Energjisë. Njëpërmjet këtij ligji përcaktohen edhe mënyrat e zbatimit ku, ndër të tjera, theksohet se kodi aktual i ndërtimit duhet rishikuar në mënyrë që të aktivizohet auditimi dhe klasifikimi energjetik i konsumatorit deri në 2018, si një proces zyrtar, i cili cilëson dhe rendit të gjithë stokun konsumator në Shqipëri. Këto procese, në dukje pa interes, janë pikërisht ato që, në rrafshin ndërsektorial energjetik në vend, do të kursenin 6.8% humbje të panevojshme. Por, aktualisht, mbështetja nga qeveria qendrore dhe MIE është e pamjaftueshme për respektimin e këtyre objektivave.

Procesi i evropianizimit dhe progresi i sektorit energjetik në Shqipëri mund të gjurmohen duke marrë në konsideratë përshtatjet ligjore në funksion të përafrimit me legjislacionin e BE-së në një kohë kur zbatimi i ligjeve dhe investimet publike nuk reflektojnë përmirësim në konsumin eficient të energjisë apo diversifikimin e burimeve gjeneruese. Megjithatë, hapa përpara janë kryer për sa i përket përafrimit të legjislacionit dhe ky është një fakt. Qeveria qendrore ka *transpozuar* Traktatin e Komunitetit të Energjisë si dhe detyrimet që rrjedhin nga Marrëveshja e Parisit, këto në Ligjin nr. 7/2017 'Për Nxitjen e Përdorimit të Energjisë nga Burimet e Rinovueshme 2018-2020', i cili së fundmi u rishikua duke u përditësuar për të pasqyruar detyrimet e sipërpërmendura. Megjithatë, si në çdo rast të trajtuar më sipër, masat e përshtatshme për të zbatuar këtë legjislacion mungojnë ose janë në proces mjaft të ngadaltë. Shumica e praktikave në funksion të liberalizimit të tregut energjetik në vend kanë qenë raste të izoluar të nxitura nga iniciativa private/personale, duke orientuar ndërmarrje private kryesisht me bazë prodhimi nga HEC-e të tregtojnë energjinë e tyre tek konsumatorët fundorë. Në këtë mënyrë mund të thuhet se qeveria ka ndjekur një drejtim të njëanshëm në liberalizimin e tregut.

Prezantimi i formave alternative të prodhimit të energjisë elektrike dhe tregtimit të saj në rrjet

